



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 3402/2 Prot.

Koplik me: 23/12 /2024

RELACION

“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR TË NËPUNËSVE CIVILË, TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË PËR VITIN 2025 TË BASHKISË MALËSI E MADHE, NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Të nderuar/a Këshilltarë/e!

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 germa ç), i ndryshuar, të Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor te RSH-së”, i ndryshuar, ligjin nr. 115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025", “Udhezimin nr. 3, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027” për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 Kodi i Punës i RSH-së i ndryshuar, ligjin nr .152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, V.K.M nr.113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi”, Urdhërit të kryetarit të Bashkisë nr. 158 datë 23/ 12/2024 për miratimin e strukturës, emërtesave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë për vitin 2025 të Bashkisë Malësi e Madhe, Njësive Administrative dhe Funksioneve të Deleguara, shkresën nr.14488 Prot, datë 29.10.2024 nga ministria e financave me lëndë, dërgim i detajimit të fondeve për transfertën e pakushtëzuar sektoriale, dhe transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme të planifikuar për vitin 2025, shkresën nr.17266 Prot datë 17.12.2024 të dërguar nga ministria e financave për dërgimin e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2025, si dhe sipas ndryshimeve të akteve nënligjore që lidhen me pagat e njësive të vetëqeverisjes vendore për të gjitha funksionet përfshirë ato që financohen me transfertë të pakushtëzuar dhe transfertë specifike paraqesim këtë relacion për miratimin e ndryshimeve si më poshtë:

- ❖ Niveli i pagave është në përputhje me V.K.M nr.503, datë 01.08.2024, Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore;(lidhjet nr.1-nr.8)

- ❖ “Specialistët”, “Përgjegjësit e Sektorëve” apo “Drejtorët e Drejtorive”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i shkencave”/“Master profesional”/ Bachelor” apo të barasvlershme me ta, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “Informatikë”, “Inxhinieri telekomunikacioni” apo “Shkenca kompjuterike”, “Teknologji informacioni”, “Informatikë ekonomike” dhe “Inxhinieri matematike informatike”,(1) përfitojnë një shtesë mbi pagë, në masën 5,000 (pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të bashkive me 50,001–100,000 banorë.
- ❖ Niveli i pagave të punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi që financohen nga transferata specifike është përcaktuar nga Ligji nr.152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi”,VKM nr.237/2014 “Per miratimin e struktures dhe te organikes se policise se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi, V.K.M nr.419, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, të ndryshuar (lidhja nr.4)
- ❖ Niveli i pagave të punonjësve të Ujitjes dhe Kullimit që financohen nga transferata specifike është përcaktuar në VKM nr.621 datë 28.09.2022 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 187 datë 08.03.2017,i ndryshuar , V.K.M nr.421, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.325 datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar; (lidhja nr.7)
- ❖ Niveli i pagave të punonjësve mbështetës që financohen me transfertë specifike përcaktohet në V.K.M nr.242 datë 20.04.2023 për disa ndryshime në vendimin nr.234 datë 20.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar,(lidhja nr.6)
- ❖ Niveli i pagave të punonjësve të arsimit parashkollor, Qendrës Kulturore të Fëmijëve dhe Konviktit Tamare të cilët trajtohen financiarisht me transfertë specifike është përcaktuar në VKM nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomësimore, në arsimin parauniversitar” i ndryshuar”, dhe V.K.M nr. 425, datë 26.06.2024 “Për miratimin e structures dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimore në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”;(lidhja nr.6)
- ❖ Niveli i pagave të punonjësve të Gjendjes Civile mbështetet në ligjin nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” dhe Niveli i pagave të punonjësve të V.K.M nr.421, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.325 datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve

civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar; (lidhja nr.5)

- ❖ Niveli i pagave të punonjësve të drejtorisë së pyjeve dhe kullotave mbështetet në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, Ligjin nr.57/2020 “Për Pyjet” dhe VKM nr.627 datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr.234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”,
- ❖ V.K.M nr.113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi”, V.K.M nr.503, datë 01.08.2024, Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore (lidhja nr.3)

Nga sa më sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij projektvendimi në zbatim të vendimeve të mësipërme.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftoj ta votoni propozimin për miratimin e këtij projektvendimi.


KRYETAR
TONIN MARINAJ